

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**

**Pasqyrat financiare individuale  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

**(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)**

## **Përmbajtje**

Rapori i audituesve të pavarur.....	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare. ....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5 – 34
Raporte plotësuese.....	i-ii



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Bordin e Drejtorëve dhe drejtimin e Sigal Uniqa Group Austria sh.a.

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Sigal Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të pakonsoliduar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, si dhe të performancës së saj financiare të pakonsoliduar dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



### *Çështje tjetër*

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër, i cili më datë 5 maj 2017 ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra financiare.

### *Informacione të tjera*

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në raportin vjetor të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 128 të Ligjit nr. 52 " Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", dhe përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raportin vjetor presim që ta kemi në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare individuale nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur t'i sigurojmë ato dhe të konsiderojmë nëse këto informacione të tjera kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare individuale, apo me njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato kanë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuadojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare individuale, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



*Raport tjetër mbi kërkesat rregullatore - kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë për Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike.*

Në bazë të kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqëruese të aftësisë paguese dhe aktivet që në mbulim të rezervave teknike. ("Skedulet plotësuese"). Këto Skedule plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë shoqëruese e pasqyrave financiare individuale. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Raportet plotësuese të përgatitur nga drejtimi, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin vjetor financiar të paraqitur në pasqyrat financiare individuale shoqëruese të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, i aplikueshëm për shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e skeduleve plotësuese, në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimeve" nr. 52 të datës 22 maj 2014.

Fatos Beqja  
*Auditues Ligjor*

KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 27 prill 2018

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e pozicionit financiar**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Aktive</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9	116,302	117,128
Depozita me afat me bankat	10	3,416,820	3,384,336
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	11	428,482	299,036
Tatim fitimi i arkëtueshëm	29	40,613	-
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	12	268,606	459,793
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	13	895,409	777,334
Investime në filiale	14	2,223,050	2,018,150
Aktive afatgjata materiale	15	699,742	734,140
Aktive të tjera	16	160,815	252,524
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>8,249,839</b>	<b>8,042,441</b>
<b>Detyrime</b>			
Rezerva për dëme	17	2,161,557	1,916,214
Rezerva për primet e pafituara	18	1,976,580	2,116,182
Tatim fitimi i pagueshëm	29	-	28,603
Detyrime të tjera	19	495,538	448,301
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>4,633,675</b>	<b>4,509,300</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	20	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	21	262,225	262,225
Fitimi i mbartur		1,121,030	1,038,007
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>3,616,164</b>	<b>3,533,141</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>8,249,839</b>	<b>8,042,441</b>

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 27 prill 2018 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari  
 Drejtor i përgjithshëm

Klement Mersini  
 Drejtor Finance



**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**
**Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Prime të shkruara bruto	22	4,003,441	4,027,385
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	18	139,602	(188,496)
<b>Primet bruto të fituara</b>		<b>4,143,043</b>	<b>3,838,889</b>
Prime të ceduara në risigurim	23	(672,344)	(697,113)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	18	(131,297)	74,713
<b>Të ardhura neto nga primi i sigurimit</b>		<b>3,339,402</b>	<b>3,216,489</b>
Të ardhura të tjera	24	63,696	82,482
<b>Të ardhura neto</b>		<b>3,403,098</b>	<b>3,298,971</b>
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	17	(245,343)	(271,970)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve	17	249,371	121,421
Dëme të paguara	17	(1,270,002)	(951,350)
Dëme të paguara të risiguruara	17	169,323	164,990
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(1,096,651)</b>	<b>(936,909)</b>
Kostot e marrjes në sigurim	25	(768,006)	(805,800)
Shpenzime administrative	26	(1,044,300)	(984,807)
Shpenzime të tjera sigurimi	27	(236,932)	(92,545)
Zhvlerësime në investimet e filialeve	14	-	(229,891)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>257,209</b>	<b>249,019</b>
Të ardhura nga investimet	28	174,124	222,118
Humbje nga kursi i këmbimit		(125,044)	(13,607)
		<b>49,080</b>	<b>208,511</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>306,289</b>	<b>457,530</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	(58,266)	(91,333)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>248,023</b>	<b>366,197</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<b>248,023</b>	<b>366,197</b>

Shënimet nga faqja 5 në 34 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.



**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Kapitali aksionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>741,680</b>	<b>3,236,814</b>
Fitimi i vitit	-	-	366,197	366,197
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>366,197</b>	<b>366,197</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërisë</b>				
Dividendë të paguar	-	-	(69,870)	(69,870)
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(69,870)</b>	<b>(69,870)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,038,007</b>	<b>3,533,141</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,038,007</b>	<b>3,533,141</b>
Fitimi i vitit	-	-	248,023	248,023
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>248,023</b>	<b>248,023</b>
<b>Transaksione me pronarët e Shoqërisë</b>				
Dividendë të paguar	-	-	(165,000)	(165,000)
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(165,000)</b>	<b>(165,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,232,909</b>	<b>262,225</b>	<b>1,121,030</b>	<b>3,616,164</b>

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra individuale e flukseve monetare**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë operative</b>			
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>248,023</b>	<b>366,197</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	15	58,286	67,811
Zhvierësime të investimeve në filiale	14	-	229,891
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		2,088	3,193
Të ardhura nga interesi	28	(21,239)	(26,504)
Të ardhura nga dividendët	28	(152,885)	(195,614)
Zhvierësime të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	11	229,418	203,044
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	58,266	91,333
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>			
(Rritja) në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		(118,075)	(196,134)
(Rritja) në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi		(358,864)	(165,428)
Pakësim/(rritje) në kostot e shtyra të marrjes në sigurim		191,187	(112,036)
Pakësim/(rritje) në aktivet e tjera		91,709	(77,266)
Rritje në rezervat për dëme		245,343	271,970
(Pakësim)/ rritje në rezervat për primet e pafituara		(139,602)	188,496
Rritje/(pakësim) në detyrimet dhe provizionet e tjera		47,237	(3,054)
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga veprimtaritë operative para interesit dhe tatimit</b>			
Tatimi fitimi i paguar		(127,482)	(75,083)
Interesa të arkëtuara		20,243	27,659
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë operative</b>			
		<b>273,653</b>	<b>598,475</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(36,625)	(22,650)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		10,649	2,356
Investime në depozita me afat		(31,488)	(528,278)
Dividend të arkëtuara	28	152,885	195,614
Rritje në kapitalin aksionar të filialeve	14	(204,900)	(208,000)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese</b>			
		<b>(109,479)</b>	<b>(560,958)</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë financuese</b>			
Dividend të paguar		(165,000)	(69,870)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese</b>			
		<b>(165,000)</b>	<b>(69,870)</b>
Pakësim neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre			
		(826)	(32,353)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		117,128	149,481
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit</b>			
	<b>9</b>	<b>116,302</b>	<b>117,128</b>

Shënimet nga faqja 5 në 34 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.